



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:029810

Datë: 21.06.2024

Numri i dokumentit: 05847919

KPPP.nr.1570/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtar Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Fondi Financiar Crimson LLC, me NRB: 70435690, me seli në Prishtinë, Rr.”Pashko Vasa” nr.22, kundër debitorit SH.P.K. “GECO GROUP”, me NRB:70981263, e përfaqësuar nga pronari A.K., me seli në Prishtinë Rr.”Imzot Nikë Prelaj” Ulpiana, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.663/21 të datës 30.11.2021 të Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani, me seli në Prizren, jashtë seancës, me datë 21.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “GECO GROUP” Sh.p.k, ndërsa Urdhri përmbartimor P.nr.663/21 të datës 30.11.2021 i lejuar nga përmbartuesi privat Mehdi S. Reshani, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Zyra Përmbartimore e Përmbartuesit Privat Mehdi S. Reshani, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lëshuar urdhër përmbartimor me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të Kontratës për kredi me numër 683 e datës 14.12.2017, Kontratës për kredi me numër 684 e datës 15.01.2018, Kontratës së Pengut për kolateral të luajtshëm / aneksi 1/684 e datës 15.01.2018, Konfirmimit të Regjistrimit R-20180517-393 i datës 17.05.2018, duke detyruar debitorin t’ia paguajnë borxhin e mbetur në shumë prej 255,514.14 €, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, ka urdhëruar të gjitha Institucionet Financiar se në rast se ka mjete atëherë të transferohen përmes llogarisë së veçantë të organit përmbartues me qëllim të përmblylljes së obligimit. Në rast të mos realizimit me anë të llogarive bankare, të sekuestrohet kolaterali i

debitorëve sipas kontratës së pengut dhe të njëjtat ti dorëzohen kreditorit për ti shitur, që nga çmimi i shitblerjes të përmbushet obligimi i debitorëve.

Kundër urdhrit përmbarimor në afatin e paraparë ligjor prapësim ka ushtruar debitori, e ka kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar urdhrin përmbarimor, manipulues dhe të falsifikuar në tërësi. Ka shtuar se asnjë fletë e kontratës dhe kontratave mbi pengun e as një planë të pagesave nuk ka nënshkrim nga ana e pronarit të kompanisë. Po ashtu ka theksuar se nuk qëndron fare pretendimi i kreditorit se ka ndonjë obligim ndaj tij, dhe se si biznes ka pushuar të gjitha aktivitetet biznesit dhe nga ajo kohe kanë qenë thujse në bankrotim, Tutje ka theksuar se nuk kanë pas asnjëherë kapacitet që të kenë këso kredi. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi si i bazuar dhe urdhri përmbarimor të hedhet.

Kreditori në përgjigje në prapësim i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara dhe të pa themelta. Ndër të tjerash ka theksuar se përmbaruesi privat ka vepruar në mënyrë të drejtë me lejin e përmbarimit të bazuar në marrëveshjen e marrëveshjet e pengut si dokumente ekzekutive të cilat debitori i ka nënshkruar. Ka shtuar se prapësimi nuk është i mbështetur në asnjë provë dhe i njëjti është në tërësi i pa bazuar. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që prapësimi të refuzohet në tërësi si i pa bazuar dhe urdhri përmbarimor të mbetet ne fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar, andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së përcaktohet se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”*, ndërsa sipas nenit 5, par.2 të Ligjit 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore përcaktohet se dokument përmbarues paraqet: *“...kontrata për pengun e regjistruar në regjistrin zyrtar të pengut...”*.

Gjykata vlerësoi se mbi bazën e Kontratës për kredi me numër 683 e datës 14.12.2017, Kontratës për kredi me numër 684 e datës 15.01.2018, kreditori me debitorët kishte lidhur

Kontratës së Pengut për kolateral të luajtshëm / aneksi 1/684 e datës 15.01.2018, e cila kontratë është objekt i përmbarimit. Gjykata gjeti se kontrata e lartcekur nuk është paraqitur në formën e kërkuar ligjore, respektivisht nuk i është bashkangjitur shkresave të lëndës në formë origjinale apo kopje të noterizuar, siç përcakton neni 38 par. 1 të LPP-së, se: *1. Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit.*”.

Në këtë drejtim, në mbështetje të nenit 71, par.1, nën-par 1.1 të LPP-së i cili përcakton se: *“Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohen vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë”* gjykata erdhi në përfundim se urdhri për lejimin e përmbarimit duhet të anulohet, pasi që dokumentet mbi bazën e të cilave është lejuar përmbarimi nuk kanë titull ekzekutiv.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike përmbarimore, andaj gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimit.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe duke u bazuar në nenin 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1570/22, datë 21.06.2024

Gjyqtari  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.